



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2024:225309
Datë: 27.02.2025
Numri i dokumentit: 06913628

C. nr. 4480/2024

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, gjyqtari Atdhe Berisha, në çështjen juridike kontestimore të paditësit F.Dz. dhe F.A. të dy nga Prizreni, të cilët me autorizim i përfaqëson Av. A.H. nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim për kompensimin e punës gjatë vikendeve zëvendësim i orëve të humbura gjatë pandemisë – Covid 19, më datë: 27 Shkurt 2025 merri këtë:

A K T V E N D I M

Hedhet poshtë padi në këtë çështje kontestimore.

A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij ka paraqitur padi për kompensimin e pagës shtesë për ditët e punës zëvendësim i orëve të humbura gjatë pandemisë Covid – 19 kundër të paditurës, Komuna e Prizrenit- Drejtoria për Arsim me të cilën ka kërkuar nga gjykata të detyron palën e paditur, që për kohën kontestuese në emër të pagës shtesë për punën gjatë vikendit për zëvendësimin e orëve të humbura të kompensohet paditësi në shumë të cilën do ta precizon pas marrjes së ekspertizës financiare, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e shkaktimit të dëmit e gjerë në pagesën definitive dhe atë në afat prej 7 ditësh nga dita plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar. Në dispozitiv e ka përcaktuar vlerën e shumës për të cilën kërkon kompensimit të pagës shtesë por jo ditët e punës gjatë vikendit, si dhe ditët e punës të cilat i kërkon.

Pasi që pala paditëse nuk ka paraqitur ditët e punës gjatë vikendeve, për të cilat kërkon kompensimi, gjykata me Aktvendim C. nr.4480/2024 datë 04 Shkurt 2025, ka kërkuar nga pala paditëse plotësimin e padisë në afat prej 3 ditësh, duke e njoftuar palën paditëse për pasojat e mosveprimit sipas atij aktvendimi.

Përkundër faktit që pala paditëse e ka pranuar aktvendimin e lartcekur, për plotësimin dhe përmirësimin e padisë nuk e ka bërë precizimin sa i përket ditëve të punës gjatë vikendit, sa ditë ka punuar dhe për cilën periudhë kohore kërkohet kompensimi.

Në kuptim të nenit 99 par. 2 lidhur me nenin 254 dhe 391 të LPK-së, parashihet që padia duhet të jetë e kuptueshme dhe të përmban çdo gjë që nevojitet sipas saj kur paditësi me padi kërkon ekzistimin e një të drejte që i takon.

Në rastin konkret pala paditëse kërkon kompensim të pagës shtesë për ditët e punës gjatë vikendit zëvendësim i orëve të humbura gjatë pandemisë Covid - 19 mirëpo paditësit

përmes të autorizuarit të tyre përkundër pranimit të vendimit për përmirësim dhe plotësim të padisë, nuk i ka përcaktuar për sa ditë pune dhe për cilën periudhë kohore kërkon kompensimin. Mbi këtë bazë gjykata nuk ka mundur të vepron sipas padisë dhe precizimit të pa përmirësuar, pasi që në mënyrën si është paraqitur kërkesa, pala e paditur nuk mundë të deklarohet në përgjigjen në padi që do ta paraqiste e cila do të detyrohej nga gjykata që brenda afatit të caktuar të paraqet përgjigje në padi. Për të cilën gjë do të lindnin pasoja për palën e paditur.

Pasi që pala paditëse përkundër faktit që gjykata ka kërkuar përmirësimin dhe plotësimin e padisë, nuk ka vepruar sipas atij aktvendimi. Gjykata në kuptim të nenit 391 par. 1 germa (g), të LPK-së vendosi të hedh poshtë padinë.

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN
C. nr.4480/2024 datë 27 Shkurt 2025

Gj y q t a r i,
Atdhe Berisha

UDHËZIME PËR ANKESË: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur mund të ushtron ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj gjykate, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.